

## **XIX PROCEDURA ADMINISTRATIVE**

### **NOCIONET KRYESORE:**

Rregullat procedurale; procedura; procedura administrative; zgjidhja e punëve administrative; aktet konkrete administrative; (aktvendime); parimet themelore të procedurës administrative; veprimet procedurale; procedura e përgjithshme administrative; procedurat e veçanta administrative; dyshkallësia (e drejta e ankimit); pala; aftësia për të qenë palë; aftësia procedurale; legjitimiteti për të qenë palë; mjetet juridike; mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike; kontesti administrativ; kontrolli administrativo gjyqësor; sistemi i gjykatave të veçanta administrative; sistemi anglosakson; inspekcioni administrativ.

### **P Y E T J E :**

1. Çfarë rregullash përmbajnë normat për procedurë administrative?
2. Kur zbatohen rregullat e procedurës administrative?
3. Çka është qëllimi për shkak të së cilës zbatohet procedura administrative?
4. Emërtoni parimet themelore të procedurës administrative!
5. Çfarë rregullash përfshin procedura e përgjithshme administrative?
6. Çka rregullohet me procedurë të veçantë administrative?
7. Çka nënkupton parimi i dyshkallësisë në procedurën administrative?
8. Kush mund të jetë palë në procedurën administrative?
9. Çka janë mjetet e jashtëzakonshme juridike?
10. Çka përfaqëson dhe çka është qëllimi i kontestit administrativ?
11. Si është sistemi i kontrollit administrativo gjyqësor të akteve administrative në RM?
12. Çka është lënda e kontestit administrative?
13. Si inicohet kontesti administrativ?
14. Kush e kryen mbikqyrjen administrativo gjyqësore?

# 1.PROCEDURA ADMINISTRATIVE

## 1.1. NOCIONI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Që të munden organet shtetërore, entet dhe organizatat që kryejnë autorizime publike, drejt t'i zbatojnë dispozitat me karakter materialo-juridik, është e nevojshme të ekzistojnë rregulla ndaj të cilave këto organe,ente dhe organizata,detyrimisht do të përmbahen kur e zbatojnë ligjin në raste konkrete individuale. Këto rregulla me të cilat rregullohet mënyra e veprimit quhen *rregulla administrative*,përkatësisht ato e përbëjnë procedurën.

Normat e procedurës administrative përmbajnë rregulla me të cilat rregullohet kompetenca,forma dhe rrjedhoja e veprimeve në procedurë si dhe forma e përmbajtjs së akteve që sillen si rezultat i procedurës nga ana e organeve shtetërore,entete dhe organizatave që kryejnë autorizime publike,ku në çështjet administrative, duke zbatuar normat materialo-juridike drejtpërsëdrejti vendosin për të drejtat,obligimet dhe interesat juridike të qytetarëve,personave juridikë dhe subjekteve që paraqiten në cilësi të palëve, si dhe rregullat për të drejtat dhe obligimet e palëve pjesmarrëse në procedurën administrative.

Pra, me rregullat mbi procedurën administrative sigurohet ligjshmëria (materiale dhe formale) e aktvendimeve që sjellin organet e autorizuar,organizatat dhe entet gjatë zbatimit të drejtpërsëdrejti të normave në raste konkrete,me çka nga njëra anë realizohet mbrojtja e të drejtave dhe interesave të qytetarëve dhe subjekteve të tjera, kurse nga ana tjetër mbrohet interesi publik.

Me fjalë të tjera, organet e autorizuar të administratës shtetërore dhe organet e tjera shtetërore, si dhe entet, organizatat, fondet, shoqatat e qytetarëve që u është besuar kryerja e autorizimeve publike, dretëpërsëdrejtë i zbatojnë ligjet nga lëmia administrativo-juridike me zbatimin e tyre në situatë dhe raporte konkrete, përkatësisht me zgjidhje në punë administrative<sup>1</sup>. Gjatë kësaj normat e përgjithshme juridike të ligjeve zbatohen në raste konkrete me të cilat vendoset për të drejtat, obligimet dhe interesat juridike të qytetarëve dhe subjekteve të tjera në procedurë dhe sillen akte administrative konkrete-aktvendime.

Veprimtaria e zgjidhjes së punëve administrative, posaçërisht në praktikë dhe puna e organeve të administratës shtetërore merr pjesë në përqindje të madhe dhe është me rëndësi ekskluzive për realizimin e të drejtave dhe intereseve të qytetarëve dhe personave juridikë. Nga kjo, me rëndësi të veçantë është që të ekzistojnë garanci, se gjatë zgjidhjes së të drejtave individuale të qytetarëve, personave juridikë dhe subjekteve të tjera në procedurë, të gjithë këto organe, organizata dhe ente do t'i përmbahen procedurës ligjore dhe do t'i respektojnë të gjitha rregullat me të cilat sigurohet zbatimi i drejtë dhe objektiv i ligjit material dhe garantohen të drejtat procedurale të palës me të cilën mundësohet realizimi i të drejtave të saj, si dhe obligimeve e interesave. Njëkohësisht dispozitat procedurale për procedurë administrative duhet ta

---

<sup>1</sup> Shiko nenin 1 të ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.(LPPA).

mbrojnë edhe interesin publik nëpërmjet përcaktimit dhe realizimit të obligimeve të qytetarëve, personave juridikë dhe subjekteve të tjera.

Rregullat e procedurës administrative zbatohen vetëm kur në punët administrative, gjatë zbatimit të drejtëpërdrejtë të ligjeve materiale vendoset për të drejtat, obligimet dhe interesat e qytetarëve, të personave juridikë ose palëve të tjera gjatë sjelljes së akteve të përgjithshme administrative (rregullore, urdhëresa, vendime, etj.), nuk zbatohen rregullat e procedurës administrative.

Procedura administrative paraqet një varg veprimesh procedurale që zhvillohen në disa etapa (inicimi i procedurës, procedura pyetësore, sjellja e aktvendimit, procedura sipas ankesës dhe ekzekutimi i aktvendimit) dhe kanë si qëllim përfundimtarë sjelljen e aktvendimit të drejtë dhe ligjor të një lëndë konkrete.

Me rëndësi të veçantë për tërësinë e procedurës administrative dhe realizimin e qëllimit të saj përfundimtar është përmbajtja dhe realizimi i parimeve themelore të procedurës administrative që në RM-së, sipas LPPA janë: parimi i ligjshmërisë; mbrojtja e të drejtave të qytetarëve dhe mbrojtja e interesit publik; parimi i efikasitetit; parimi i së vërtetës materiale; dëgjimi i palëve; parimi i vlerësimit të lirë të dëshmimeve; pavarësi në vendosje; parimi i dyshkallësisë (e drejta në ankesë); parimi plotëfuqishmërisë; parimi i ekonomizimit të procedurës; ndihmë palës së paditur; dhe parimi i përdorimit të gjuhës dhe shkrimit.

## **1.2. PROCEDURA E PËRGJITHSHME DHE PROCEDURAT E VEÇANTA ADMINISTRATIVE**

Ekzistojnë dy lloj procedurash administrative: procedura e përgjithshme administrative dhe procedurat e veçanta administrative.

Procedura e përgjithshme administrative përmban rregulla të cilat janë të përbashkëta për veprim dhe punë të numrit më të madh të organeve shtetërore, ente dhe organizatat të cilat kryejnë autorizime publike në rastet kur ato, gjatë zbatimit të normave materialo-juridike, vendosin për të drejtat, obligimet dhe interesat juridikë të qytetarëve dhe personave juridikë. Rregulla të tilla përmban ligji për procedurë të përgjithshme administrative.

Por, ekzistojnë raste të caktuara kur nuk mund të zbatohen rregullat e procedurës së përgjithshme administrative, është e nevojshme të ekzistojnë rregulla specifike dhe mënyra të veçanta të punës për organet shtetërore, pë entet dhe organizatat. Në ato raste zbatohen lloje të veçanta të procedurës administrative, përkatësisht procedura të veçanta administrative, me të cilat gjithashtu rregullohen kompetenca, forma e veprimit dhe sjellja e akteve por vetëm për organe të caktuara dhe lëmi të caktuara. Procedurat e veçanta administrative rregullohen me ligje të veçanta dhe procedura të tilla janë p.sh. procedura në punët doganore, procedura në punët tatimore, punët devizore, në punë të veçanta inspektuese, procedura për inspektim, arondim, komosacion, etj.

Procedura e përgjithshme administrative, në raport me procedurat e veçanta administrative, ka karakter plotësues, respektivisht ajo zbatohet nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë një procedurë e veçantë administrative dhe nëse çështjet të caktuara nuk janë rregulluar me normën me të cilën përcaktohet procedura e veçantë administrative.

Përpyekjet që të mblidhen dhe sistematizohen rregullat e procedurës së përgjithshme administrative janë të kohës më të re dhe i gjejmë në pak vende në botë. Kodifikimi i parë i procedurës së përgjithshme administrative është kryer në vitin 1925 në Austri (ligji për procedurë të përgjithshme administrative).

Shumë shpejt pas kësaj, në vitin 1928 është bërë kodifikimi në Cekoslovakia dhe Poloni, kurse në vitin 1930 është aprovuar ligji për procedurë të përgjithshme administrative edhe në Jugosllavinë e vjetër, me çka ajo numërohet në mes të vendeve të para në botë me rregulla të kodifikuara të procedurës administrative<sup>2</sup>. Në vitin 1946 është aprovuar ligji i njëjtë në SHBA ( Federal Administrative Procedure Act ) kurse në vitin 1957 Hungaria bëri kodifikimin e procedurës së përgjithshme administrative. Në Spanjë Ligji Për Procedurë të Përgjithshme Administrative është sjellë në vitin 1958. Kodifikime të Procedurës Administrative janë aprovuar edhe në Gjermani (në vitin 1976), Bullgari (në vitin 1979), Danimarkë (në vitin 1985), Portugali (në vitin 1991 ), dhe në Hollandë (në vitin 1994).

Ligji nga Jugosllavia e vjetër është zbatuar edhe pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1956, kur RSFJ aprovoi Ligjin për Procedurë të Përgjithshme Administrative, i cili hyri në fuqi në vitin 1957. Ligji është plotësuar edhe ndryshuar në vitin 1965 dhe në vitin 1977. Me aprovimin e kushtetutës së RM-së dhe Ligji Kushtetues për zbatimin e Kushtetutës në vitin 1991 kjo dispozitë është marrë si dispozitë Republikane dhe ende vlen në territorin e Republikës së Maqedonisë .

### 1.3. DYSHKALLËSIA E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Dyshkallësia e Procedurës, respektivisht e drejta në ankesë, paraqet parimin kushtetues dhe njëkohësisht parimin themelor në procedurën Administrative. Neni 15 i Kushtetutës së RM-së e garanton të drejtën në ankesë “kundër akteve juridike individuale të sjella në procedurë në shkallë të parë para Gjykatës, organit Administrativ, organizatës, ose institucionit që kryen autorizime publike”.

Dyshkallësia e procedurës administrative është jashtëzakonisht e rëndësishme për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të qytetarëve dhe e personave juridikë. Dyshkallësia në esencë do të thotë se çështja Administrative mund të zgjidhet në dy instanca. Organi i shkallës së parë (më i ulët) e zgjidh lëndën kurse organi i shkallës së dytë ( më i lartë) i vlerëson arsyet e ankesës, nëse pala në procedurë është e pakënaqur nga aktvendimi i shkallës së parë.

---

<sup>2</sup> Ky ligj ka hyrë në fuqi në Shkurt të vitit 1931.

**Kundër Aktvendimit të sjellë në bazë të ankesës, pala nuk ka të drejtë tjetër në ankesë, respektivisht nuk ka instancë të tretë që do të vendoste për atë rast. Por, nëse pala edhe më tutje konsideron se me aktvendimin janë të cënuara të drejtat dhe intereset juridike të saj, ajo ka të drejtë në mbrojtje Administrativo-Gjyqësore përkatësisht me padi mund të iniciojë kontest Administrativ para Gjykatës Supreme të RM-së.**

**Parimi i dyshkallësisë do të thotë rregull se pas ankesës kundër aktvendimit të shkallës së parë mund të vendosë vetëm edhe një herë organi drejtëpërdrejtë më i lartë e sipas kësaj me aktvendimin e organit të shkallës së dytë përfundon vendosja në procedurë Administrative. Kjo do të thotë se në procedurë Administrative mund të vendoset për lëndë individuale vetëm në dy shkallë.**

**Dyshkallësia, respektivisht e drejta e ankesës ka rëndësi ekskluzive për forcimin e përgjegjësisë së organit të shkallës së parë i cili ka vendos në çështjen administrative. Organi i shkallës së dytë (organi më i lartë) paraqitet në rolin e kryerësit të kontrollit ndaj organit të shkallës së parë dhe mund ta ndryshojë, fuqizojë ose ta anulojë aktvendimin e shkallës së parë. Nga kjo, Organi më i ulët çdoherë do të mbajë llogari për atë fakt gjatë sjelljes së aktvendimit dhe do të tentojë ai të jetë sa më objektiv, respektivisht sa më saktë ta zbatojë ligjin. Me të drejtën e ankesës pala fiton mundësi për mbrojtje juridike kur konsideron se ekziston shkelja e ligjit, respektivisht se në rstatin konkret nuk është zbatuar drejt.**

**Ankesa është mjet juridik i rregullt me të cilin pala ose personi tjetër zyrtar deklaron qëllim përkatësisht dëshirë që aktvendimi i shkallës së parë përsëri të rishqyrtohet dhe të përmirësohet nga ana e Organit më të lartë.**

**Me ankesë kërkohet të anulohet ose të ndyshohet aktvendimi joligjor ose i gabuar ( i papërshtatshëm) i shkallës së parë.**

**Neni 11 i Ligjit për Procedurë të përgjithshme administrative (LPPA) e shpreh parimin e dyshkallësisë në procedurën administrative në mënyrën vijuese:**

- **Kundër aktvendimit të shkallës së parë pala ka të drejtën e ankesës;**
- **Vetëm me Ligj mund të caktohet se në punë të caktuara administrative, ankesa nuk është e lejuar, edhe atë nëse në mënyrë tjetër është e siguruar mbrojtja e të drejtave dhe ligjshmëris. Kjo don të thotë se me dispozit më të ulët se Ligji nuk mund të mohohet e drejta për ankesë.**

**Të ralla janë rastet kur ajo bëhet më ligj ashtu siç e lejon ligji për procedurën Administrative (LPPA) . Por, dhe në ato raste detyrimisht duhet të sigurohet një mënyrë tjetër për mbrojtjen e të drejtave dhe të ligjshmërisë;**

- **Nëse nuk ekziston organi administrativ i shkallës së dytë, ankesa kundër aktvendimit të shkallës së parë mund të deklarohet vetëm kur është e pa paraparë me ligj. Me atë ligj do të caktohet edhe organi që do të vendosë për ankesën;**
- **Sipas kushteve të këtij ligji pala ka të drejtë në ankesë edhe kur organi i shkallës së parë në afatin e caktuar nuk ka sjellë aktvendim për kërkesën e saj ( heshtja e administratës ).**
- **Kundër aktvendimit të sjellë në shkallë të dytë nuk është e lejuar ankesa.**

#### 1.4. PALA NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Pala, në procedurën administrative, është person sipas kërkesës së të cilit është inicuar procedura ( pala aktive ) ose personi kundër të cilit zhvillohet procedura ( pala pasive), respektivisht personi i cili për shkak të mbrojtjes së të drejtave të veta ose të interesave juridike ka të drejtë të marrë pjesë në procedurë ( pala e interesuar ose intervenuesi ).<sup>3</sup>

Procedura administrative mund të udhëhiqet vetëm më një palë (procedura administrative njëpalëshe ), për dallim nga procedurat gjyqësore në të cilat gati se çdo herë marrin pjesë dy palë me interesa të kundërta mes të cilëve ekziston kontesti. Gjithashtu në procedurën administrative mund të marrin pjesë dy ose më tepër palë me interese ose kërkesa të kundërta (lëndë dypalëshe ose shumëpalëshe). Në procedurën administrative mund të marrin pjesë edhe më shumë palë me interese të njëjta të cilat paraqiten si një palë në raport me organin i cili e udhëheq procedurën administrative. Në këtë rast bëhet fjalë për bashkësi procedurale të cilat mund të formohen për bazë dhe për arsye të procedurës administrative (bashkësi procedurale formale) ose ekzistojnë pavarësisht nga udhëheqja e procedurës (bashkësi proceduralo materiale).

Si palë në procedurën administrative mund të paraqiten të gjithë personat fizikë pa marrë parasysh moshën e tyre, persona juridikë ( shoqëri tregtare, ente, bashkësi të qytetarëve, qytete, komuna, shteti, etj) dhe subjekte të tjera të cilat nuk janë persona juridikë por mund të paraqiten si bartës të të drejtave dhe obligimeve për të cilat vendoset në procedurë administrative (organet shtetërore, njësitë punuese, kuartet, grupet qytetarëve, organizatat sindikale kur procedura administrative ka të bëjë me ndonjë të drejtë ose interes juridik të punëtorëve).

Të gjitha këto subjekte detyrimisht duhet të kenë aftësi të jenë bartës të të drejtave dhe obligimeve (të cilat janë përcaktuar me norma materiale nga lëmia e caktuar administrative si p.sh. mbrojtja sociale ) që të paraqiten si palë në procedurën administrative (aftësia e të qenurit palë); detyrimisht duhet të jenë të aftë vet ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të marrin pjesë në procedurë t'i mbrojnë dhe t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre (aftësia procedurale); dhe në procedurë të vendoset për të drejtat e tyre, interesat juridike ose obligimet (legjitimiteti për të qenë palë ).

#### 1.5. MJETET JURIDIKE NË PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

Siç është thënë aneksa në procedurë administrative është mjet i rregullt juridik me të cilën pala e pakënaqur ka të drejtë të përmirësojë aktvendimin e shkallës së parë. Ajo quhet mjet i rregullt juridik sepse paraqet pjesë të procedurës së rregullt administrative e cila sipas parimeve së dyshkallësisë së procedurës mund të shqyrtohet në dy shkallë.

Por, në procedurën administrative janë të lejuara edhe mjete tjera juridike me të cilat arrihet përmirësimi i aktvendimeve joligjore të cilat janë sjellë si rezultat i procedurës së rregullt administrative të përfunduar, por me të

---

<sup>3</sup> Shiko nenin 49 nga LPPA.

cilat janë cënuar të drejtat ose interesat juridike të palës, është cënuar edhe interesi publikë. Këto mjete juridike nuk zbatohen rregullisht por në situatë ekskluzive, përkatësisht nën kushte rreptësisht të përcaktuara, të cilat i parasheh LPPA, sepse ndërmirren kundër aktvendimeve (të përfunduara, të plotëfuqishme ose të ekzekutueshme), me të cilat procedura e rregullt administrative është përfunduar, ose ndryshe thënë në këto aktvendime më janë krijuar raporte të caktuara administrativo-juridike dhe janë fituar të drejtat ose obligimet e sigurta për palët.

Prandaj, situatat e këtilla mund të jenë lëndë e ndryshimit vetëm nën kushte ekskluzive. Për këtë shkak ata quhen mjete të jashtëzakonshme juridike, ndërsa qëllimi i tyre është që të eliminohen gabimet me karakter më të lehtë ose më të rëndë të cilat e cënojnë ligjshmërinë e aktvendimeve të sjella. Në ligjin për procedurë administrative ekzistojnë 7 mjete të jashtëzakonshme juridike me të cilat mund të anulohen, shfuqizohen ose ndryshohen aktvendimet e sjella në procedurë administrative: përsëritja e procedurës; ndryshimi dhe anulimi i aktvendimit lidhur me kontestin administrative; kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë; anulimi dhe shfuqizimi i aktvendimit me të drejtë mbikqyrjeje; shfuqizimi dhe ndryshimi i aktvendimit të plotëfuqishëm me pëlqim ose me kërkesë të palës; shfuqizimi i jashtëzakonshëm i aktvendimit; dhe shpallja e aktvendimit si të pavlefshëm (nul).

## 2. KONTESTET ADMINISTRATIVE

Kontesti administrativ është formë e kontrollit të organizuar sistematik gjyqësor mbi ligjshmërinë e akteve administrative. Për dallim nga kontrolli i ligjshmërisë së akteve administrative që kryhen brenda suazave të vetadministratës, respektivisht në pushtetin ekzekutiv, ose nga ana e organeve më të larta administrative në procedurë të ankesës ose me të drejtën e mbikqyrjes, kontrollimi administrativo -gjyqësorë bëhet nga ana e gjykatave me çka sigurohet shkalla më e lartë e pavarësisë dhe objektivitetit në mbrojtjen dhe realizimin e parimit të ligjshmërisë, në punën e organeve të administratës dhe të subjekteve të tjera të cilat gjatë kryerjes së autorizimeve publike vendosin për çështje administrative nga lëmia e të drejtave, obligimeve dhe interesave juridike të qytetarëve dhe personave tjerë juridik. Në kontestin administrativ, gjykata është arbitër mes këtyre organeve, subjekteve, qytetarëve dhe personave juridikë të cilët janë palë plotësisht të barabarta.

Qëllimi themelor i kontestit administrativ është që të sigurojë kontrollin gjyqësor të parimit të ligjshmërisë nga ana e sjellësit të akteve administrative, respektivisht kontroll në raport me atë se këto akte a janë sjellë në pajtim me normat materiale dhe procedurale. Pra, me institucionin e kontestit administrativ, qytetarët dhe personat juridikë fitojnë mundësi për mbrojtje të plotë të të drejtave dhe interesave të tyre, ndërsa pengohet arbitraliteti dhe tekanjoziteti i sjellësve të akteve administrative. Në disa vende para së gjithash Franca por edhe në Austri, Itali, Gjermani, etj, kontrollin gjyqësor për ligjshmërinë e akteve e kryejnë gjyqe të veçanta administrative. Këto gjyqe në mënyrë institucionale janë pjesë e pushtetit ekzekutiv dhe janë plotësisht të pavarur, dhe në kuadër të procedurës posaçërisht të rregulluar, kanë të drejtë të

kryejnë kontroll juridike mbi aktet administrative respektivisht të vendosin për çështjet kontestuese rreth ligjshmërisë së akteve konkrete administrative.

Ky model i gjyqësisë administrative emërohet si sistem kontinentalo Evropian ose sistem i gjyqjeve të veçanta administrative.

Në vendet e tjera siç janë Anglia ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kontrollin gjyqësor ndaj ligjshmërisë së akteve të administratës e kryejnë gjyqet e rregullta. Ky sistem quhet *sistemi anglosakson*.

Në Republikën e Maqedonisë vlen sistemi i vendosur në kuadër të ish RSFJ-së dhe me aprovimin e ligjit për konteste administrative në vitin 1952 dhe ligjin e mëvonshëm për konteste administrative të vitin 1977 i cili vlen edhe tash. Sipas këtij sistemi që është në mes të dy sistemeve paraprakisht të përmendura, kontrollin gjyqësor mbi ligjshmërinë e akteve administrative e kryen gjyqi i rregullt përkatësisht Gjykata Supreme e RM-së, por ai zbaton procedurë të posaçme e cila nuk është gjyqësore por është e rregulluar me Ligjin për konteste administrative. Përveç kësaj për zgjidhjen e kontesteve administrative në Gjykatën Supreme është kompetent seksioni i posaçëm administrativ i përbërë nga dy këshilla gjyqësore me nga 3 gjykatës.

Lëndë e kontestit administrativ gjithmonë është akti administrativ i përfunduar, respektivisht akti me të cilin vendoset për të drejtat, detyrimet ose interesat juridike të qytetarëve dhe të personave juridikë. Nga kjo rrjedh se në sistemin tonë, lëndë e kontestit administrativ nuk mund të jetë akti i përgjithshëm administrativ. Përveç kësaj aktet e cakturara konkrete administrative janë të përjashtuara nga kontesti administrativ me klauzolë eksplicite në ligj.<sup>4</sup> Kontesti administrativ çdoherë zhvillohet për ligjshmërinë e aktit administrativ. Gjykata e vlerëson vetëm ligjshmërinë e aktit, përkatësisht a është sjellë në pajtim me ligjin. Nëse Gjykata vërteton se akti është joligjor ai do ta anuloj aktin kurse organi që e ka sjellë aktin e anuluar është i obliguar të sjellë akt të ri në pajtim me vlerësimin juridik dhe me vërejtjet e Gjykatës, nëse për lëndën duhet të silllet akti i ri ( p.sh. nëse Gjykata anulon aktvendimin me të cilin themelohet obligim i sigurt për qytetarin nuk do të ketë nevojë për sjellje të aktvendimit të ri nga ana e prurësit të aktvendimit të anuluar). Vetëm në raste ekskluzive Gjykata përveç vlerësimit të ligjshmërisë së aktit është i autorizuar të vendos edhe vet lëndën administrative ( i ashtuquajtur i kontest i jurisdiksionit të plotë). Në këto raste ekskluzive aktgjykimi i Gjykatës në tërësi e zëvendëson aktvendimin e anuluar.

Kontesti administrativ çdoherë fillon me kërkesë ( padi ) të palës së pakënaqur. Si paditës në kontestin administrativ mund të paraqiten të gjitha subjektet që mund të marrin pjesë në procedurë administrative në cilësi të palës (individ, person juridik, kuart, grup qytetarësh, organ shtetëror, organizatë, prokurori publikë, etj). Palë e paditur është sjellës i aktit administrative të përfunduar (konkret) që kontestohet (organi i administratës, organi tjetër shtetëror, subjekte që kryejnë autorizime publike, etj).

---

<sup>4</sup> Neni 9 nga ligji mbi kontestet administrative.

Në kontest administrativ si palë mund të marrin pjesë edhe persona të tretë të interesuar kur anulimi i aktit të kontestuar është në dëm të drejtëpërdrejtë të tyre. Arsyet për shkak të cilave një akt administrativ konkret i përfunduar mund të sulmohet janë:

- nëse në akt nuk është zbatuar aspak ose është zbatuar në mënyrë jo të rregullt ligji ose dispozita tjetër e zbatuar në ligj.
- nëse akti është sjellë nga organi jokompetent
- nëse në procedurën e cila nuk i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës e posaçërisht nëse gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt, nga faktet e vërtetuara është nxjerrë përfundimi i padrejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Aktgjykimet që i sjellë Gjykata në kontestet administrative janë të obligueshme për të gjithë, si për palët në kontest ashtu edhe për personat e tretë. Në raste ekskluzive mund të parashtrahet ankesë kundër aktgjykimeve, dhe aktvendimeve të sjella në kontestin administrativ. Si mjete juridike të jashtëzakonshme në procedurën administrativo-gjyqësore janë të njohura: 1. Përsëritja e procedurës administrativo gjyqësore dhe 2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

### 3. INSPEKZIONI ADMINISTRATIV

Inspekcioni administrativ përfshin mbikqyrjen për ekzekutimin e ligjit për procedurë të përgjithshme administrative dhe të ligjeve të tjera që përmbajnë dispozita për procedurë administrative të cilët posaçërisht i përkasin:

- veprimet në afatet e caktuara në procedurën e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë.
- realizimi efikas i të drejtave dhe interesave të qytetarëve dhe personave juridikë.
- përfshirjes me kohë të palëve të interesuara në procedurë për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të tyre.
- sigurimit të dëshmive zyrtare për faktet për të cilat udhëhiqet evidenca zyrtare nga organi që vendos për lëndën ose nga organi tjetër shtetëror ose organizatë tjetër;
- ekzekutimit të akteve administrative të plotëfuqishme; dhe
- ekzekutimit të normave për punë në zyrë dhe përgatitje profesionale të punëtorëve që kryejnë veprime në procedurën administrative.

Kjo mbikqyrje administrativo-inspektuese kryhet në organet e administratës shtetërore, organizatat, entet, shoqatat e qytetarëve dhe subjektet e tjera të cilat në kryerjen e autorizimeve publike vendosin në lëndë individuale për të drejta dhe obligime të caktuara, në shërbimet profesionale të kuvendit, qeveris, gjykatave, prokurorisë publike, zyrave të avoketëve dhe Entit për qarkullim pagesor.

Punët e inspekcionit administrative i kryejnë inspektorët në kuadër të Inspektoratit administrativ shtetëror si organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë.

Në kryerjen e punëve nga kompetenca e vet, inspektorët janë të autorizuar:

- të realizojnë observim në ekzekutimin e ligjeve dhe dispozitave të tjera si dhe të kërkojnë të dhëna të nevojshme për atë;
- të urdhërojnë eliminim e mangësive në zbatimin e ligjeve dhe të dispozitave të tjera;
- të urdhërojnë mënyra të caktuara të veprimit të organit të administratës ose të subjekteve të tjera që kryejnë autorizime të tjera publike;

Në kryerjen e inspektimit administrative inspektori u jep ndihmë juridike qytetarëve në realizimin e të drejtave dhe ekzekutimin e obligimeve në procedurë administrative si dhe u sugjerojn organeve, organizatave, enteve dhe personave tjerë juridik që kryejnë autorizime publike për mënyrat e mundshme e realizimit më efikas të interesave të qytetarëve në procedurë administrative. Nga ana tjetër subjektet e përmendura që vendosin për lëndë administrative janë të obliguar që inspektorit t'i mundësojn observim të drejtëpërdrejtë, kryerje të papenguar të mbikqyrjes administrative dhe me kërkesë të tij t'ia dërgojnë të dhënat e nevojshme dhe materialet, në afat që ai do t'ua caktojë.

Kundër aktvendimit të inspektorit me të cilin urdhërohet ekzekutimi i masave ose veprimeve për eliminim të mangësive në zbatimin e ligjeve dhe të dispozitave të tjera, organet, organizatat, entet dhe subjektet e tjera në të cilat është kryer mbikqyrja inspektuese kanë të drejtë ankese deri te Ministri i Drejtsisë në afat prej 8 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

Qytetarët, ndërrmarrjet dhe subjektet e tjera të cilat, në realizimin e të drejtave të tyre, interesave dhe obligimeve do të vërejnë negativitete të caktuara në punën e organeve, organizatave, enteve dhe subjekteve të tjera që kryejnë autorizime publike, mund të inicojnë iniciativa deri te Inspekcioni administrativ dhe të japin propozime për kryerje të mbikqyrjes inspektuese.

Ligji për inspekcionin administrativ i cili edhe tash vlen në RM është i aprovuar në vitin 1979 dhe disa herë ka pësuar plotësime dhe ndryshime, mes të cilave më thelbësore në vitin 1987. Nevoja për sjelljen e ligjit të ri për inspekcion administrativ në RM është i domosdoshëm jo vetëm për shkak të harmonizimit terminologjik por edhe për shkak të harmonizimit të radhitjes organizative, të strukturës dhe rolit të këtij organi në rendin e ri shoqëroro-politik të RM-së.